



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M
K.P.P. 358/2021

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 12.07.2021 shqyrtoi ankesën përkatësisht me:

Objekt: Shfuqizim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Alpha Solutions Group” ShPK në procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur”, me nr. REF-91857-03-30-2021, me objekt: “Blerje e matësave të ujit dhe rakorderive plotësuese të tyre”, me fond limit 12 575 167 lekë pa tvsh, zhvilluar në datën 04.05.2021 nga autoriteti kontraktor, Ujësjetllës Kanalizime, Lushnjë SH.A.

Ankimues: “Alpha Solutions Group” ShPK
Lagjia 29 Nëntori, Rruga” Pinellopi Piro”, Pallati 26, Shkalla 0, Aparatamenti 6 Fier

Autoriteti Kontraktor: Ujësjetllës Kanalizime, Lushnjë SH.A.
Lagjia “ 18 Tetori ” Lushnjë

Baza Ligjore: Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për

Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përçaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 31.03.2021, është publikuar nga autoriteti kontraktor, në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit “prokurimit prokurimit “Procedurë e Hapur”, me nr. REF-91857-03-30-2021, me objekt: “Blerje e matësave të ujit dhe rakorderive plotësuese të tyre”, me fond limit 12 575 167 lekë pa tvsh, zhvilluar në datën 04.05.2021 nga autoriteti kontraktor, Ujësjellës Kanalizime, Lushnjë SH.A.

II.2. Në datën 04.05.2021, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE) si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor në datë 18.05.2021 ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedure prokurimi të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. “Alpha Solutions Group” ShPK	12.491.100 lekë	skualifikuar
2. “Ervin Luzi” p.f.	10.900.000 lekë	skualifikuar

II.4. Në datën 18.05.2021, operatori ekonomik “Alpha Solutions Group” ShPK është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi me arsyen si më poshtë:

Operatori ekonomik Alpha ka paraqitur një autorizim nga operatori Alen&Co shpk në të cilin ky operator cilësohet si distributor zyrtar i disa prodhuesve për mallrat që prokurohen. Ndërkohë nga të gjitha autorizimet e prodhuesve të paraqitur me dokumentat nga prodhuesit për të vërtetuar lidhjen e prodhuesit me distributorin, operatori Alen&Co është distributor i vetëm dy prodhuesve Arangul plastik dhe Apator Poëergas, për prodhuesit e tjerë si me poshtë : Plasterm, Poelsan ,Raci SRL, Taizhou Rida Valve Co LTD, I Oblecinia Zaëierva SA dhe Gokerplast Plastik San. Ve.Tic LTD STI operatori Alen&Co nuk është distributor zyrtar por është operator i autorizuar për të marrë pjesë në tendera, për të dhëna oferta dhe për të përfaqësuar prodhuesit kur këta ia kërkojnë, për llogari të vetën, dmth për llogari të Alen&Co . Ne asnjë nga këto autorizime nuk citohet që ky ka të drejtë të autorizojë palë të treta për pjesmarrje në tender me autorizim nga prodhuesi. Rrjedhimisht operatori Alpha nuk ka të drejtë të tregtojë produktet e këtyre prodhuesve. Mosplotësimi qoftë edhe i një kriteri të vendosur nga ana e autoritetit kontraktor e bën ofertën e operatorit ekonomik të pavlefshme.

II.5. Në datën 24.05.2021 operatori ekonomik “Alpha Solutions Group” ShPK ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar skualifikimin e ofertës së tij ekonomike duke argumentuar si më poshtë vijon:

[...] Autoriteti Kontraktor sha Ujësjetllës Kanalizime Lushnjë ka shpallur në sistemin elektronik procedurën me objektin e mësipërm e cila është zhvilluar në datën 04.05.2021. Shoqëria jonë pjesëmarrëse në procedurën e prokurimit me objektin e mësipërm organizuar nga Ujësjetllës Kanalizime Lushnjë në datën 08.05.2021 jemi nohur nëpërmjet SPE me renditjen e operatorëve ekonomikë pjesmarrës si dhe arsyen e skualifikimit tonë nga kjo procedurë. Duke shqyrtuar argumentat e AK-së ne mendojmë se jemi skualifikuar pa të drejtë nga kjo procedurë. Duke shqyrtuar argumentat e AK-së ne mendojmë se jemi skualifikuar pa të drejtë nga kjo procedurë. Bazuar në këto argumenat AK-ja kërkon që në autorizimin e distributorit të cilësohet se distributori të ketë të drejtë të autorizojë kompani të tjera për të marrë pjesë në tendera dhe kjo është arsyeja që nuk e pranon autorizimin që ne kemi nga kompania “Alen-Co” shpk dhe/ose autorizimin që shoqëria “Alen-Co” shpk ka nga prodhuesit e saj. Theksjmë se autorizimi i prodhuesit për distributorët nuk ka një format standard dhe për më tepër që në kriteret për kualifikim të tenderit nuk është paraqitur ndonjë format standard i autorizimit të prodhuesit ose distributorit. Prandaj skualifikimi i shoqërisë tonë për shkak se autorizimi i distributorit nuk është i saktë dhe që ai nuk ka të drejta të autorizojë kompani të tjera nuk qëndron.

Për më tepër edhe ato autorizime distributori që ju i keni quajtur të pranueshme nuk shkruajnë në asnjë rast se “Alen-Co” shpk ka të drejtë të autorizojë kompani të tjera për të marrë pjesë në tendera. Nuk mund të pretendohet që prodhues të ndryshëm në botë të kenë të njëjtin format autorizimi për distributorët. Në rastin kur prodhuesi shkruan që kompania “Alen –Co” shpk është përfaqësuesi ynë (siç janë disa autorizime të paraqitur nga shoqëria “Alen –Co” shpk do të thotën edhe se ai është distributor për territorin e Shqipërisë. Për më tepër nëse ju keni dyshime për shoqërinë “Alen-Co” shpk nëse është distributor ose jo dhe nëse ka të drejtë të autorizojë kompani të tjera për të marrë pjesë në tendera jeni të lutur të kontaktoni me kompanitë prodhuese me telefon ose me mail (këto informacione i gjeni në autorizimet që prodhuesi i ka dhënë shoqërisë Alen-Co shpk, dhe të verifikoni që kjo kompani ka të drejtë të na autorizojë edhe neve për të marrë pjesë në tendera dhe për të shitur produktet e tyre. Theksojmë se autorizimi i prodhuesit ose distributorit kërkohet nga AK-ja me qëllimin vërtetimin se kompania ofertuese e produkteve ka kontakte me prodhuesin ose ditributorin e tyre.

Ky kontakt tregon se kompania ofertuese në këtë rast “Alpha Solutions Group” ShPK ka për ti ofruar produktet që ka deklaruar pa vonesa dhe nëpërmjet shoqërisë Alen –Co shpk. Pra shoqëria jonë do i blejë produktet te shoqëria Alen co shpk ndërsa këta të fundit tek prodhuesit përkatës dhe më pas ju mund ti verifikoni të gjithë produktet që ne po ju paraqesim. Për këtë çështje ne jemi të gatshëm të ofrojmë dhe dokumenta të tjera shtesë (në rast se shpallemi fitues dhe lidhim kontratën me autoritetin tuaj), si certifikatë orgjine dokumenta transportietj për tju vërtetuar mënyrën se si do i blejmë mallrat e ofruara e në këtë mënyrë vërtetojmë më së miri lidhjen tonë pra ofertues “Alpha Solutions Group” ShPK distributor/përfaqësues (Alen –Co” shpk – prodhuesit.

Si dëshmitë argumentimeve tona të mësipërme brenda këtij afati të shkurtër shoqëria jnë pasi kontaktoi me shoqërinë Alen-Co shpk arriti të siguronte një dokumnt tjetër shtesë nga një prej prodhuesve, të cilët deklarojnë se shoqëria Alen Co shpk ka të drejtë të autorizojë kompaninë tonë për këtë procedurë(i bashkëngjitet kësaj shkrese dokumenti në fjalë).

Në përfundim ne mendojmë se argumentat tuaja nuk qëndrojnë dhe ne kërkojmë kualifikimin e shoqërisë tonë në këtë procedurë. Nëse keni dyshime për të drejtat që shoqëria Alen Co shpk ka në lidhje me autorizimet që ajo mund të lëshojë daj palëve të treta jeni të lutur të kontaktoni prodhuesit me mail ose telefon dhe ta verifikoni (veprim që mund/duhet të ishte kryer nga ju përpara se të shpreheshit për vendimin që keni dhënë[....].

II.6. Referuar informacionit dhe dokumentacionit të dorëzuar pranë KPP, nga autoriteti kontraktor, si dhe dokumentacionit bashkëlidhur ankesës së operatorit ekonomik ankimues konstatohet se autoriteti kontraktor me anë të shkresën nr.174/8 prot, datë 28.05.2021, i ka kthyer përgjigje ankesës së operatorit ekonomik “Alpha Solutions Group” ShPK duke e refuzuar ankesën në lidhje me procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.7. Në datën 04.06.2021 operatori ekonomik “Alpha Solutions Group” ShPK ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik me të njëjtin objekt ankesë drejtuar autoritetit kontraktor.

II.8. Nëpërmjet shkresës nr. 174/10 prot., datë 17.06.2021, protokolluar me tonën në datën 18.06.2021, me objekt “Shkresë përcjellëse”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik

informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit dhe trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, si edhe informacionit dhe dokumentacionit të autoritetit kontraktor

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Alpha Solutions Group” ShPK për kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij me arsyetimin se “*Operatori ekonomik Alpha ka paraqitur një autorizim nga operatori Alen&Co shpk në të cilin ky operator cilësohet si distributor zyrtar i disa prodhuesve për mallrat që prokurohen. Ndërkohë nga të gjitha autorizimet e prodhuesve të paraqitur me dokumentat nga prodhuesit për të vërtetuar lidhjen e prodhuesit me distributorin , operatori Alen&Co është distributor i vetëm dy prodhuesve Arangul plastik dhe Apator Poërgas, për prodhuesit e tjerë si me poshtë : Plasterm, Poelsan ,Raci SRL, Taizhou Rida Valve Co LTD, I Oblectinia Zaëierva SA dhe Gokerplast Plastik San. Ve.Tic LTD STI operatori Alen&Co nuk është distributor zyrtar por është operator i autorizuar për të marrë pjesë në tendera, për të dhëna oferta dhe për të përfaqësuar prodhuesit kur këta ia kërkojnë, për llogari të vetën, dmth për llogari të Alen&Co . Ne asnjë nga këto autorizime nuk citohet që ky ka të drejtë të autorizojë palë të treta për pjesmarrje në tender me autorizim nga prodhuesi. Rrjedhimisht operatori Alpha nuk ka të drejtë të tregtojë produktet e këtyre prodhuesve. Mosplotësimi qoftë edhe i një kriteri të vendosur nga ana e autoritetit kontraktor e bën ofertën e operatorit ekonomik të pavlefshme.*”, Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se:

III.1.1. Në Shtojcën 9 të modifikuar “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, pika 2.3.3. “Kapaciteti teknik të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi është kërkuar:

2.3.3. *Operatori Ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizim prodhuesi ose autorizim nga distributori i autorizuar per mallrat objekt prokurimi. Ne rast paraqitje te autorizimit nga distributori, OE duhet te paraqese dokumentacionin per te vertetuar se subjekti ne fjale eshte distributor zyrtar.*

III.1.2. Në shtojcën 12 “Sasia dhe Grafiku i Lëvrimit” të dokumenteve të procedurës objekt ankimimi është kërkuar:

Sasia e mallit që kërkohet:

<i>Nr.</i>	<i>Nr. An</i>	<i>Përshkrimi</i>	<i>Njësia</i>	<i>Sasia</i>	<i>Çmimi Njësi</i>	<i>Vlera</i>
PREVENTIVI						
1	An	Sahate uji 1/2	copë	4000	-	-
2	An	Bashkuese 20 mm *1/2 mashkull	copë	2000	-	-
3	An	Brryl PE 25 * 1/2 mm mashkull	copë	300	-	-
4	An	Brryl PE 20 * 1/2 mm mashkull	copë	3000	-	-
5	An	Brryl 1/2 me fileta PPR	copë	100	-	-
6	An	Brryl 3/4 me fileta PPR	copë	100	-	-
7	An	Xhunto PPR 25 mm x 1/2 mashkull	copë	50	-	-
8	An	Xhunto PPR 20 mm * 1/2 mashkull	copë	100	-	-
9	An	Niples 1/2 bronxi	copë	8000	-	-
10	An	Manikot 1/2 xingato	copë	1000	-	-
11	An	Pastë Hidraulike	copë	50	-	-
12	An	Litar Lini	copë	100	-	-
13	An	Mufte 3/4 me 1/2 xingato	copë	500	-	-
14	An	Saracineske 1/2 bronxi me leve	copë	4000	-	-
15	An	Kundravalvula 1/2 bronxi	copë	4000	-	-

16	An	Vula matesi	copë	10000	-	-
17	An	Tapa xingato	copë	500	-	-
18	An	Mates uji 3/4	copë	50	-	-
19	An	Saracineske 3/4 bronxi me leve	copë	50	-	-
20	An	Kundravalvul 3/4 bronxi	copë	50	-	-
21	An	Niples 3/4 bronxi	copë	100	-	-
22	An	Manikot 3/4 xingato	copë	50	-	-
23	An	Bashkuese 25 mm *1/2 mashkull	copë	200	-	-
		Shumatorja e Cmimit për Njësi			-	
		Shuma pa Tvsh				-
		TVSH 20 %				-
		TOTALI				-

Afatet e lëvrimit: 12 (dymbëdhjetë) muaj nga data e lidhjes së Draft – Marrëveshjes, sipas nevojave dhe kërkesave të Autoritetit Kontraktor.

III.1.2. Nga shqyrtimi dhe verifikimi i dokumentacionit të operatorit ekonomik ankimues te ngarkuar ne sistemin e prokurimeve elektronike, konstatohet se është paraqitur dokumentacioni si më poshtë:

Dokumenti me emërtimin “Autorizim i distributori, lëshuar nga Alen Co shpk, ku citohet se: “[...]Shoqëria “ALEN-CO” sh.p.k, me Nr.NIPT: K83213401M, me seli në Fier dhe Tiranë, jemi distributor zyrtar të , “APATOR POËOGAZ” SA, ” NTG PLASTIK SANAYI VE TICARET A.S”, “GOKERPLAST PLASTIK SANAYI VE TICARET L.T.D.STI.”, “POELSAN PLASTIK SANAYI VE TICARET A.S ”, “ODLEËNIA ZAËIERCIE SA”, “Taizhou Rida Valves co., Ltd.”, “C.Z IT DEVELOPMENT CO.,LTD”, “Foshan SongQi Technology Co., Ltd”, “PILANA METAL s.r.o.”,

“MES METAL EKSTRUZYON SANAYI VE TICARET A.S”, “FUCOLI-SOMEPAL Fundação de Ferro S.A”, “T&Y Hardëare industry CO.,LTD”, “UAB BLUCAST “, “ARANGUL PLASTIK KALIP SAN.VE TIC.LTD.STP”, “ROMACON PIPELINE PRODUCTS B.V.”, “PLASTHERMPLATIN ISI MAKÏNA MÛDENDÏSTLÏK TAAHHÛT VE TÏCARET LTD.ŞTÏ.”, “SHANGHAI KAMAL TRADING CO., LTD”, “SHANGHAI KAMAL TRADING CO., LTD”, “PESTAN D.o.o”, “LINZHOU FENGBAO PIPE INDUSTRY CO., LTD”, “RACI S.r.l” etj, autorizon shoqërinë“ALPHA SOLUTIONS GROUP” sh.p.k, me Nr.NIPT: L63620402U, me seli në Fier, Lagjja 29 Nentori, Rruga Pinellopi Piro, Pallati 26, Shkalla 0, Apartamenti 6 , të ofrojë pranë autoritetit kontraktor SH.A Ujesjellës Kanalizime Lushnjë, të gjithë gamën e mallrave të prodhuara nga kompanitë, për të cilat ne jemi distributor zyrtar, për procedurën e prokurimit që do të zhvillohet më datë 04.05.2021, me objekt “Blerje e matësive të ujit dhe rakorderive plotësuese të tyre”. Me këtë shkresë ne japim autorizimin tonë të plotë për shoqërinë e sipërcituar dhe garantojmë për mallrat e ofruara nga kompania e lartëpërmendur[...]

Certifikatë ISO 9001:2015 ARANGUL PLASTIK KALIP SANAYI VE TICARET LIMITED SIRKETI, (Prodhim dhe shitjen e tubave plastikë dhe rakorderive lidhëse), PLASTIK BORU VE BAGLANTI EK PARACALARI IMALATI VE SATISI, Nr. i certifikatës: QMS-09743, data e certifikimit fillestar 03.04.2020, data e vlefshmërisë së certifikatës 02.04.2022.

Dokumenti me emërtimin “Letër e deklaratës, lëshuar nga Apator Poëogaz SA, ku citohet se: “[...] Alen-CO shpk është distributor i autorizuar në Shqipëri me të gjitha produktet që ata kanë nevojë dhe ne prodhojmë[...]

Certifikatë ISO9001:2015 (APATATOR SA)

Certifikatë (APATAOR POËGAZ SA)

Deklaratë konformiteti(prodhuesi Apator Poëogaz SA (matës uji me një motorr dhe me helikë JS për ujë të ftohtë dhe të ngrohtë)

Certifikatë ekzaminim tipi EU PRODHUESI: Apator Poëogaz SA (PËR: matësja ujë –single jet me fushë të thatë. (bashkëlidhur dokumenti karakteristikat e instrumentit faqe 2-11).

Pjesë katalogu SMART+ (MATËS UJI I THATË ME NJË RRJEDHJE). LOGO: Apator

Dokumenti me emërtimin “Autorizim i PRODHUESI datë 13.06.2019 lëshuar nga nga OBLEËNIA Zaëiercie SA , ku citohet se: “[...]Alen Co shpk të veprojë si përfaqësues i OBLEËNIA Zaëiercie SA në Shqipëri. Kjo kompani ka të drejtë të shpërndajë produktet tona, të japë suport teknik, të marrë dokumenta tenderimi, të negociojë, të japë oferta dhe të marrë pjesë në tendera për llogari të vetë dhe mund të veprojë në llogari tonë në raste të tilla kur ne kemi kërkuar dhe instruktuar kështu[...]

Certifikatë ISO 9001:2015; 14001:2015;45001:2018 OBLEËNIA ZELIËA.

CERTIFIKATË DDIN-DVGË(FUSHA E APLIKIMIT: Produktet e gazit dhe ujësjellsave

Pjesë katalogu

Dokumenti me emërtimin “Autorizim i PRODHUESI datë 10.04.2019 lëshuar nga nga Gokerplast Plastik San. Ve Tic LTD STI. , ku citohet se: “[...]Alen –co” shpk është autorizuar për të marrë pjesë në tendera shtetërorë brenda territorit Shqiptar me produktet tona[...]
Certifikatë ISO9001:2015 (Gokerplast Plastik San. Ve Tic LTD STI)

Raport testimi

Raport inpektimi

test raport

pjesë katalogu GP110 pjesë katalogu GP150 për telave të vulave për aplikime të ndryshme[..]

Dokumenti me emërtimin “Autorizim i PRODHUESI datë 22.02.2020 lëshuar nga nga PLASTHERM PLATIN ISI MAKINA MUDENDISTLIK TAAHHUT VE TIACARET , ku citohet se: “[...] autorizojmë partnerin tonë në Shqipëri “Alen-Co” shpk të paraqesim oferta, të shesim produktin tonë dhe të ofrojmë garanci tek ata për të negocuar vetë me sjelljen e tyre kontratën për qëllime të tenderit në Shqipëri[...]

Certifikatë ISO9001:2015 (PLASTHERM PLATIN ISI MAKINA MUDENDISTLIK TAAHHUT VE TIACARET)

certifikatë ekzaminimi DVGË (FUSHA E APLIKIMIT:produkte të furnizimit me ujë).

pjesë katalogu PLASTHERM

Dokumenti me emërtimin “Autorizim i PRODHUESI datë 11.04.2018 lëshuar nga nga ARANGUL Plastik San. Ve Tic LTD STI, ku citohet se: “[...] Me këtë deklarojmë që ne do të furnizojmë “ALEN-CO” Ltd me të gjitha produktet që ata kanë nevojë me produktet që prodhojmë[...]

fletë katalogu ARANGUL

Dokumenti me emërtimin “Autorizim i PRODHUESI datë 20.08.2019 lëshuar nga nga POELSAN PLASTIK SENAYI VE TICARET AS, ku citohet se: “[...] me anë të kësaj autorizojmë kompaninë “Alen-Co” shpk të japë ofertë kundrejt ftesave për ofertë qëllimi itë cilave është të furnizojë me mallrat e mëposhteme të prodhuara nga ne rakorderi kompresion dhe rrjedhimisht të shpërndajë ofrojë në tender negociojë dhe të nënshkruaj kontrata.Me anë të kësaj ne e zgjasim garantinë tonë në përputhje me dokumentat etenderit sipas klauzolave nëpërmjet produkteve të ofruara nga firma më sipër si përgjigje ndaj ftesës për ofertë[...]

Certifikatë ISO 9001:2015 POELSAN PLASTIK SENAYI VE TICARET AS

pjesë katalog POELSAN

Dokumenti me emërtimin “Autorizim i PRODHUESI datë 24.11. 2019 lëshuar nga nga RACI I, ku citohet se: Alen-Co shpk të veprojë si përfaqësues I RACI S.r.l. për qëllime tenderimi në Shqipëri. Kësaj kompanie i është dhënë e drejta të shpërndajë produktet tona, të sigurojë mbështetje teknike, të marrë dokumente ofertë të negociojë propozojë oferta dhe të marrë pjesë në tendera me llogarinë e tyre dhe mund të veprojë në emrin tonë në raste të tilla kur ne kemi kërkuar ose udhëzuar për të vepruar në këtë formë[...]

Certifikatë ISO 9001:2015 RACI S.r.l.

pjesë katalog RACI

Dokumenti me emërtimin “Autorizim i PRODHUESI datë 11.01.2019 lëshuar nga nga Taizhou Rida Valve CO , ku citohet se: Alen-Co shpk është e lejuar të distribuojë produktet tona të japë suport teknik të maarë dokumenta tenderi të ndërmarrë negociata të japë ofertë dhe të marrë pjesë në tendera për llogari të vet dhe të veprojë në emrin tonë në ato raste kur ne kemi kërkuar dhe udhëzuar[.]”

Certifikatë ISO 9001:2015 Taizhou Rida Valve CO
certifikatë e konformitetit sanitar (Taizhou Rida Valve CO)
pjesë katalog Taizhou Rida Valve CO

III.1.3. Në nenin 46, pika 1 gërma “a” dhe “b” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese. a) kualifikimi profesional: çdo operatori ekonomik i kërkon licencat profesionale, industriale apo tregtare, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetëror, për veprimtaritë e kërkuara dhe për të cilat do të lidhet kontrata; b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;”

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcaktohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit.

III.1.4. KPP gjykon se kriteret e veçanta për kualifikim kanë si synim kryesor që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.1.5. Nga shqyrtimi në tërësi i dokumentacionit të dorëzuar në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton se operatori ekonomik “Alpha Solutions Group” ShPK ka paraqitur në ofertën e tij dokumentin autorizim distributori, konkretisht, referuar këtij dokumenti lëshuar nga shoqëria “Alen CO” ShPK në të cilin citohet: “[...]Shoqëria “ALLEN-CO” sh.p.k, me Nr.NIPT: K83213401M, me seli në Fier dhe Tiranë, jemi distributor zyrtar të GOKERPLAST PLASTIK SANAYI VE TICARET L.T.D.STI; PLASTHERMPLATIN ISI MAKİNA MÜDENDİSTLİK TAAHHÜT VE TICARET LTD.ŞTİ.[...] autorizon shoqërinë “ALPHA SOLUTIONS GROUP”

sh.p.k, me Nr.NIPT: L63620402U, me seli në Fier, Lagjja 29 Nentori, Rruga Pinellopi Piro, Pallati 26, Shkalla 0, Apartamenti 6 , të ofrojë pranë autoritetit kontraktor SH.A Ujesjellës Kanalizime Lushnjë, të gjithë gamën e mallrave të prodhuara nga kompanitë, për të cilat ne jemi distributor zyrtar, për procedurën e prokurimit që do të zhvillohet më datë 04.05.2021, me objekt “Blerje e matësive të ujit dhe rakorderive plotësuese të tyre”. Me këte shkresë ne japim autorizimin tonë të plotë për shoqërinë e sipërcituar dhe garantojmë për mallrat e ofruara nga kompania e lartpërmendur[...], KPP konstaton se operatori ekonomik ankimes ka distributor zyrtar kompaninë “Alen Co” shpk, i cili merr përsipër të ofrojë të gjithë gamën e mallrave të prodhuara nga kompanitë e sipërcitura për të cilat kompania “Alen Co” shpk është distributor zyrtar. Dukë qënë se në këtë rast është paraqitur autorizim distributori në përmbushje të kriterit të sipërcituar rezulton se ndër të tjera në përmbushje të kriterit të sipërcituar, ky i fundit ka paraqitur “Autorizim Prodhuesi”, më datë 10.04.2019 lëshuar nga kompania Gokerplast Plastik San. Ve Tic LTD STI. Në këtë autorizim (citohet): “[...]Alen –Co” shpk është autorizuar për të marrë pjesë në tendera shtetërorë brenda territorit Shqiptar me produktet tona[...]”. Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se autorizimi i lëshuar nga prodhuesi nuk shfaqet në cilësinë e një autorizimi të distributorit zyrtar, por një autorizim i lëshuar nga prodhuesi drejtuar vetëm për një operator ekonomik konkretisht operatorin ekonomik “Alen Co” shpk, në të cilin jepen kompetencat të paraqesë oferat e tij . Konkretisht, me anë të autorizimit të mësipërm të lëshuar nga prodhuesi, në asnjë rast nuk janë dhënë kompetencat dhe tagrat e rishitjes së palëve të treta. KPP vlerëson se *stricto sensu* autorizimi i prodhuesit është lëshuar për operatorin ekonomik “Alen Co” SHPK. Sa më sipër, konstatohet se distributori “Alen Co” SHPK nuk ka patur të drejta rishitje, veçse kompetenca vetëm për të paraqitur ofertë si operator ekonomik pjesëmarrës. Referuar Autorizimit të Prodhuesit në asnjë rast nuk i është dhënë e drejta shoqërisë “Alen Co” SHPK për të qënë rishitës për këtë procedurë prokurimi. Akoma më tej referuar dokumentacionit të administruar në procedurën e prokurimit objekt ankimi të dorëzuar nga operatori ekonomik “Alpha Solutions Group” ShPK, bashkëngjitur ankesës, konstatohet se është dorëzuar edhe Dokumenti me emërtimin “Autorizim i prodhuesi” datë 24.05.2021 lëshuar nga Prodhuesi Gokerplast Plastik San. Ve Tic LTD STI ku ndër të tjera deklaroi se: “Kompania “Alen Co” shpk ka të drejtë të autorizojë kompaninë “Alpha Solutions Group” ShPK të marrë pjesë në emër të tyre në tenderin me objekt “Blerje e matësive të ujit dhe rakorderive plotësuese të tyre” dhe me nr. ref-91857-03-30-2021 hartuar nga Ujesjellës Kanaliime Lushnjë”[...]. Nga shqyrtimi dhe verifikimi i këtij dokumenti KPP konstaton se data e zhvillimit të procedurës së prokurimit është më 04.05.2021 ndërsa dokumenti me emërtimin Autorizim i prodhuesi që në këtë rast është autorizuar edhe operatori ekonomik “Alpha Solutions Group” ShPK mban datën 24.05.2021. Rjedhimisht KPP gjykon se vet operatori ekonomik ankimes ka paraqitur dokumentacion i cili nuk është në përputhje me kërkesat e parashikuara në dokumentat e tenderit referuar dokumentit të paraqitur nga ky i fundit me qëllim përmbushjen e kriterëve të veçanta të kualifikimit për procedurën objekt shqyrtimi. Sqarojmë se, bazuar në nenin 82 pika 1 të ligjit 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i RSH”, barra e provës për të vërtetuar plotësimin e kriterit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor, bie mbi operatorin ekonomik, i cili në rastin konkret ka dështuar ta vërtetojë atë. Synimi i kërkesës së autoritetit kontraktor për paraqitjen e autorizimit të prodhuesit ose autorizimit nga distributori zyrtar i autorizuar për mallrat objekt prokurimi është garantimi që ofertuesi ka aftësi të mjaftueshme për të realizuar me sukses dhe cilësi kontratën me autoritetin kontraktor, duke furnizuar brenda kohës së përcaktuar mallra origjinale, me garanci, pra autorizimi nga

prodhuesi/distributori zyrtar është një dokument nëpërmjet të cilit autoriteti kontraktor sigurohet që subjekti/shoqëria që lëshon këtë dokument, autorizon operatorin ekonomik që t'a furnizojë me produktet e tij duke siguruar garancinë e mallit.

Sa më lart, Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik ankimes nuk është në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit.

Pretendimi i operatorit ekonomik "Alpha Solutions Group" ShPK, nuk qëndron

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 "Për miratimin e rregullave "Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik", nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 "Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19", Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik "Alpha Solutions Group" ShPK për procedurën e prokurimit me "Procedurë e Hapur", me nr. REF-91857-03-30-2021, me objekt: "Blerje e matësive të ujit dhe rakorderive plotësuese të tyre", me fond limit 12 575 167 lekë pa tvsh, zhvilluar në datën 04.05.2021 nga autoriteti kontraktor, Ujësjetës Kanalizime, Lushnjë SH.A.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshme të procedurës së prokurimit.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 986Protokolli;Datë 04.06.2021

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaid Myzyri